



Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregun e punës



Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregun e punës

Qershor 2020

Përmbajtja

3 Përmbledhje ekzekutive

4 Rritja e papunësisë si pasojë e situatës së emergjencës së shëndetit publik

12 Pakot emergjente fiskale për zbutjen e rreziqeve të papunësisë

18 Përfundim

Përmbledhje ekzekutive

Si pasojë e pandemisë së koronavirusit dhe mbylljes së bizneseve, një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës mbetën papritmas të pa punë. Kjo ka bërë që numri i qytetarëve të regjistruar si të papunë pranë zyreve të punësimit të rritet dukshëm. Vetëm në muajin prill 2020, Agjencia e Punësimit bashkë me 34 zyret e saj lokale kanë regjistruar gjithsej 32,377 punëkërkuar të rinjë. Kjo ka bërë që numri i punëkërkuarve të regjistruar për periudhën janar-prill 2020 të shkojë në 37,392. Gati gjysma e tyre (16,820) janë gra. Marrë parasysh shkallën shumë të lartë të joaktivitetit ekonomik të grave dhe barrierave të tjera në punësim, shkalla e papunësisë në mesin e grave mund të rritet edhe më shumë.

Për të ndihmuar bizneset dhe qytetarët e goditur financiarisht nga pandemia, më 30 mars 2020, Qeveria e Kosovës aprovoi Pakon Emergjente Fiskale me një vlerë prej rreth 179 milionë euro. Katër ditë më vonë, Ministria e Financave dhe Transfereve aprovoi edhe Planin Operacional për Pakon Emergjente Fiskale, i cili përmbante procedurat dhe kriteret për përfitim nga 15 masa që synojnë të ndihmojnë disa kategori të shoqërisë të prekura direkt nga pandemia. Ndër kategoritë e synuara, e që janë edhe fokus kryesor i këtij studimi, janë personat që kanë mbetur të pa punë si pasojë e ndalimit të veprimtarive biznese me urdhër të Ministrisë së Ekonomisë të datës 23 mars 2020.

Përveç asistencës mujore në vlerë prej 130 euro për tre muaj për qytetarët që humbën vendin e punës për shkak të pandemisë (masa 8) dhe asistencës mujore në vlerë prej 130 euro për tre muaj për qytetarët e papunë dhe me kushte të rënda sociale (masa 15), Pakoja Emergjente Fiskale parasheh edhe mbështetje financiare për shoqëritë tregtare të cilave u ka rënë veprimtaria gjatë kohës së pandemisë, duke ua mbuluar shpenzimet e pagave mujore të punonjësve të tyre në vlerë prej 170 euro për dy muaj (masa 3.a) bashkë me mbulimin e kontributeve pensionale për ato paga (masa 3.c).

Kjo ndihmë shtetërore ka nxitur një numër të madh të aplikacioneve. Numri i ndërmarrjeve që kanë aplikuar për kompenzim me nga 170 euro për punonjësit e tyre është 37 mijë, kurse totali i punëtorëve të përfshirë në këtë masë është 133 mijë. Por, komisionet verifikuese kanë gjetur mangësi të shumta në këto aplikacione, gjë që ka rezultuar me vetëm rreth 41 mijë punonjës përfitues në muajin prill. Në anën tjetër, masa 14 e pakos emergjente që parasheh mbështetje financiare prej 130 euro për dy muaj për ato kompani që në kohë të pandemisë regjistrojnë punëtorë me kontrata punë një vjeçare, ka bërë që numri i punëtorëve të rinj në sektorin privat të rritet për afro 15 mijë persona.

Duke përdorur të dhënat më të fundit të Agjencisë së Punësimit, Fondit Pensional dhe Ministrisë së Financave dhe Transfereve, ky raport synon të ofrojë një analizë të hershme të ndikimit të pandemisë COVID-19 në tregun e punës, me theks në ndikimin e masave intervenuese të qeverisë në zbutjen e rreziqeve të papunësisë. Duke parë trendin pozitiv të regjistrimit të punonjësve të rinj për të përfituar nga pakoja emergjente, ky raport vjen në përfundim se disa nga masat e përkohshme të qeverisë mund të shndërrohen në politika afatgjate për uljen e ekonomisë joformale.

Rritja e papunësisë si pasojë e situatës së emergjencës së shëndetit publik

Që nga paraqitja e rasteve të para të infektimit me COVID-19 në Kosovë më 13 mars 2020, numri i të infektuarve ka shkuar duke u rritur vazhdimisht. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP), deri më sot, në Kosovë janë shënuar 1,048 raste me Koronavirus, ndërsa numri i të shëruarve ka arritur në 801.¹ Ndërkohë, rreth 250 individë mesatarisht testohen për shenja të virusit secilën ditë. Një prej pasojave të menjëhershme të arritjes së pandemisë në Kosovë ishte rritja e madhe e blerjes së produkteve ushqimore dhe barërave pasi që qytetarët e Kosovës synonin të siguronin rezerva për një kohë të gjatë.² Rritja e çmimeve të disa produkteve esenciale sikurse mielli ka pasur ndikim të menjëhershëm tek kategoritë sociale.

Qeveria e Kosovës ka marrë masa të rrepta për kufizimin e lëvizjes së individëve dhe operimit të bizneseve me qëllim të uljes së numrit të të infektuarve. Më 23 mars 2020, Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS) mori vendim për ndalimin e një numri të madh të veprimtarive ekonomike.³ Ndër llojet e bizneseve më të prekura që nga fillimi i pandemisë ishin gastronomia, tregjet e mëdha dhe hotelieria. Edhe bizneset dhe shërbimet me operim të lejuar, sikurse marketet, furrat dhe farmacitë, kërkohej t’iu përmbaheshin masave të rrepta higjienike gjatë operimit.⁴

Por, kufizimi i lëvizjes së qytetarëve dhe mbyllja e bizneseve rezultuan në një ngadalësim të ekonomisë. Edhe ashtu, tregu i punës dhe punësimit në Kosovë karakterizohet me shkallë të lartë të papunësisë (25.7%), me shkallë të ulët të punësimit (30.1%), me shkallë shumë të lartë të popullsisë që janë në moshë pune por që nuk janë ekonomikisht aktiv (59.5%), me një shkallë të lartë të papunësisë së të rinjve (49%), me një shkallë shumë të ulët të punësimit të grave (14%) si dhe me papunësi afatgjate ku 62% e të papunëve të regjistruar janë të papunë afatgjatë (mbi 12 muaj).⁵

Megjithatë, të dhënat tregojnë se përhapja e pandemisë në Kosovë e shoqëruar me kufizimin e lëvizjes dhe mbylljen e shumë veprimtarive afariste, pati një ndikim të menjëhershëm në papunësinë në vend. Edhe të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) tregojnë për ndryshime të mëdha para dhe pas pandemisë.⁶ Për shembull, industria që punëson më së shumti punëtorë në Kosovë – ajo e tregtisë me shumicë e pakicë – shënoi ulje drastike të punëtorëve. Siç shihet në Figurën 1, përderisa në mars të vitit 2019 në këtë industri punonin rreth 80 mijë punonjës, në mars 2020 ky numër ra në rreth 43 mijë. Ulja e punëtorëve ndodhi edhe në industrinë e ndërtimitarisë, ku në periudhën e njëjtë krahasuese numri ka rënë prej 21 mijë në vetëm 10 mijë, si dhe në atë të industrisë përpunuese ku pati rënie prej rreth 34 mijë në rreth 22 mijë.

1 Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike. 28. Maj 2020. Burimi: <https://bit.ly/2zCT6w7>

2 Ariana Kasapollari-Selani, “Qytetarët Shtojnë Blerjet Duke Grumbulluar Rezerva Ushqimore,” Radio Evropa e Lirë, 12 Mars, 2020. Burimi: <https://bit.ly/2WBkzGe>


3 Lista e të gjitha veprimtarive të ndaluara nga MEPTINIS me 23.03.2020. Burimi: <https://bit.ly/2X2l2Bw>

4 “Udhëzues për bizneset për masat që duhen të ndërmerren për parandalimin e koronavirusit,” MEPTINIS, 15 Mars, 2020. Burimi: <https://bit.ly/3dkZDKr>

5 “Anketa e Fuqisë Punëtore 2019.” Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2019. Burimi: <https://bit.ly/2ZoFVzQ>

6 Sqarim: për shkak se Ministria e Financave dhe Transeferëve e ka zgjatur deklarinimin e tatimeve deri në fund të prillit 2020, numri i saktë i punëtorëve në këto industri nuk mund të dihet tani <https://bit.ly/3erSUPL>


Figura 1. Numri i punëtorëve në industri me më së shumti punëtorë gjatë viteve 2019 dhe 2020



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Krahas të dhënave të ATK, edhe të dhënat nga Fondi Pensional i Kosovës (Trusti) tregojnë për një ulje të konsiderueshme të kontributpaguesve gjatë muajit prill të këtij viti. Figura 2 tregon se komunat si Prizreni, Ferizaji dhe Gjakova panë rënie prej 20% në krahasim me muajin dhjetor të vitit 2019.

Figura 2. Dhjetë komunat me më së shumti rënie të kontributpaguesve gjatë muajit prill 2020



Burimi: Trusti i Kosovës. Kalkulimi: Instituti GAP

Sa i përket llojit të ndërrmarjeve, shumica e tyre kanë shënuar rënie të lartë gjatë prillit 2020 në krahasim me muajin dhjetor 2019, ku organizatat buxhetore, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara (Sh.P.K) dhe bizneset individuale pësuan më shumë se 20% ulje të kontributpaguesve, ndërkaq organizatat jo-qeveritare dhe ortakëritë panë rënie prej më shumë se 40%.


Tabela 1. Kontributpaguesit gjatë muajve dhjetor 2019 - prill 2020 në bazë të llojit të ndërrmarjeve

Lloji i ndërrmarjes	31 dhjetor 2019	31 mars 2020	30 prill 2020	Diferenca dhjetor 2019 - prill 2020	Diferenca në % dhjetor 2019 - prill 2020
Organizata Buxhetore	119,736	86,753	87,939	31,797	27%
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK)	168,289	117,003	128,425	39,864	24%
Biznes individual	71,361	48,643	54,201	17,160	24%
Shoqëri aksionare	30,386	24,525	25,196	5,190	17%
Organizata Jo Qeveritare (OJQ)	22,726	9,755	12,040	10,686	47%
Të tjera	8,099	5,390	5,801	2,298	28%
Ortakëri	4,234	2,382	2,535	1,699	40%
Parti politike	3,463	307	338	3,125	90%
Bashkësi Fetare	1,290	993	1,012	278	22%
Oda ekonomike	481	208	227	254	53%
Sindikata	340	201	341	0	0%
Ambasada	190	178	184	6	3%
Agjension i Huaj Qeveritar	152	149	149	3	2%
Patneritet i kufizuar	27	22		-	-
Konsorciume	16	12	12	4	25%
Përfaqësues fiskalë	6	5	5	1	17%
Zyra përfaqësie në Kosovë	5	6	8	-3	-60%

Burimi: Trusti i Kosovës. Kalkulimi: Instituti GAP

Në shumicën e veprimtarive të lartëpërmendura, gjatë muajit prill 2020, kontributdhënësit ishin kryesisht burra, të cilët paraqesin 57% e kontributpaguesve të organizatave buxhetore, 68% në shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (Sh.P.K), 66% në biznese individuale dhe 77% në shoqëri aksionare.


Figura 3. Kontributpaguesit në Trustin e Kosovës gjatë muajit prill 2020



Burimi: Trusti i Kosovës

Në anën tjetër, të dhënat nga Agjencia e Punësimit e Kosovës tregojnë për një rritje të shpejtë të numrit të të papunëve. Duke marrë parasysh që pandemia e koronavirusit shkaktoi rënie të punëtorëve prej industrive të ndryshme, Pakoja Emergjente Fiskale ishte një hap i duhur për t'i zvogëluar efektet e pandemisë në ekonomi të Kosovës. Megjithatë, pasi që Masa 15 e pakos parasheh një pagesë mujore në vlerë prej 130 euro për qytetarët të lajmëruar si të papunë pranë entit të punësimit (dhe që janë me kushte të rënda sociale apo që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga Buxheti i Kosovës), kjo mund të ketë qar në një rritje tejet të lartë të punëkërkesve të regjistruar gjatë muajit prill 2020. Më saktësisht, nga muaji mars numri i punëkërkesve u rrit për 31,550 apo u shumëfishua për afro 40 herë. Kjo bëri që numri i përgjithshëm i punëkërkesve pranë Agjencisë së Punësimit të shkojë në 37,392 deri në prill 2020, një rritje enorme në krahasim me periudhën e fundit katërmujore të vitit 2019 kur numri i punëkërkesve ishte vetëm 6,882.


Figura 4. Trendi i punëkërkesve gjatë viteve 2019 dhe 2020



Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Punëkërkesit e rinjë të vitit 2020 ishin kryesisht burra në grupmoshën 25-39 vjeç (6,023), me gratë të po të njëjtës grupmoshë që zënë vendin e dytë (4,900). Më së paku punëkërkes kishte të moshave mbi 55, ku vërehet një ndarje e njejtë me më shumë burra (2,444) se sa gra (1,942) sikurse në Figurën 5.

Figura 5. Mosha dhe gjinia e punëkërkesëve gjatë muajit prill 2020



Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Nga Tabela 2 mund të vërehet se numri më i madh i punëkërkuessve të regjistruar aktualisht janë mes moshës 25-39 vjeç (62%), ndërkaq edhe kategoria 15-24 vjeç përbënë një numër të konsiderueshëm prej 48%


Tabela 2. Punëkërkuessit e regjistruar sipas moshës dhe gjinisë janar-prill 2020

Grupmosha	Totali	Gra	Burra
15 - 24	10,176	4,312	5,864
25 - 39	13,083	5,713	7,370
40 - 54	9,456	4,726	4,730
55+	4,677	2,109	2,568

Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Më së shumti punëkërkuess të regjistruar burra ka Prishtina (1,443) dhe Gjakova (1,423), ndërsa më së paku ka nga Peja (841) dhe Ferizaji (817). Në anën tjetër, më së shumti punëkërkuess gra ka nga Gjakova (1,891) dhe Prishtina (1,368), ndërsa më së paku ka nga Peja (861) dhe Skënderaj (837). Vetëm në komunat Prishtinë, Skënderaj dhe Mitrovicë Veriore ka më shumë punëkërkuess gra se sa burra sikurse në Figurën 6.

Figura 6. Dhjetë komunat me më së shumti punëkërkuess të rinjë gjatë periudhës janar-prill 2020



Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Megjithatë, punëkërkuess të regjistruar ka në të gjitha komunat e Kosovës sikurse që mund të vërehet në Tabelen 3.

Tabela 3. Punëkërkesit e regjistruar janar-prill 2020 sipas komunave

Komuna	Totali	Gra	Burra
Fushë Kosovë	172	82	90
Glllogoc	887	385	502
Graçanicë	607	242	365
Lipjan	2,411	1,157	1,254
Novobërdë	156	81	75
Obiliç	564	269	295
Podujevë	1,466	755	711
Prishtinë	2,811	1,443	1,368
Dragash	917	367	550
Malishevë	822	226	596
Mamushë	18	1	17
Suharekë	1,654	676	978
Prizren	2,430	1,202	1,228
Istog	532	217	315
Klinë	177	65	112
Pejë	1,702	841	861
Deçan	305	106	199
Gjakovë	3,314	1,423	1,891
Junik	52	15	37
Rahovec	613	164	449
Leposaviq	452	258	194
Mitrovicë	2,195	1,059	1,136
Skënderaj	1,706	869	837
Vushtrri	996	506	490
Zubin Potok	712	360	352
Zveçan	480	250	230
Ferizaj	2,121	817	1,304
Hani i Elezit	256	75	181
Kaçanik	527	121	406
Shtërpcë	77	31	46
Shtime	580	226	354
Gjilan	1,862	846	1,016
Kamenicë	445	150	295
Klllokot	248	121	127
Partesh	150	79	71
Ranillug	265	134	131
Viti	1,029	369	660
Mitrovica Veriore	1,681	873	808
Total	37,392	16,861	20,531

Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Më së shumti punëkërkuës ka në profesione elementare, që përfshinë pastrues(e) apo ndihmës(e), punonjës(e) në bujqësi, miniera, asistent(e) në gastronomi, transport, apo shërbim rrugësh (20,982) dhe punonjës(e) të zejes (4,982), ndërsa më së paku ka në profesione të forcave të armatosura (11) dhe menaxherë (202).⁷ Punëkërkuëset kryesisht zgjedhnin profesione elementare (10,757) dhe në lidhje me shërbime dhe shitje (1,889), ndërsa më së paku kishte punëkërkuëse për forca të armatosura (7) dhe operatore në fabrika (39). Ndërkaq, punëkërkuësit poashtu zgjedhnin kryesisht profesione elementare (10,225) dhe si punonjës të zejes (4,115), dhe më së paku kishte në forcat e armatosura (7) dhe operatorë në fabrika (400). Për profesione në forcat e armatosura apo si profesionistë ka më shumë punëkërkuëse gra se sa punëkërkuës burra siç tregon Tabela 4.

Tabela 4. Profesione të përzgjedhura nga punëkërkuësit e rinj gjatë periudhës janar-prill 2020


Profesioni	Totali	Gra	Burra
Profesionet e forcave të armatosura	11	7	4
Menaxherët	202	94	108
Profesionistët	2,678	1,553	1,125
Teknikët dhe bashkëpunëtorët profesional	2,297	927	1,370
Punëtorë zyreje dhe asistentë	1,425	640	785
Punëtorët për shërbime dhe shitje	3,782	1,889	1,893
Punëtorët e aftësuar në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	648	142	506
Punonjësit e zejes dhe profesioneve të ngjashme	4,928	813	4,115
Operatorët dhe instaluesit në fabrika dhe makina	439	39	400
Profesionet elementare	20,982	10,757	10,225
Total	37,392	16,861	20,531

Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

⁷ Ndarja e profesioneve, ILO. Burimi: <https://bit.ly/36zNSxv>

Sa i përket arsimit të punëkërkesëve, pjesa dërmuese apo 60% e këtyre punëkërkesëve janë të pashkolluar, ndërsa 29% kanë përfunduar shkollën fillore dhe të mesmen profesionale. Rreth 7% janë me gjimnaz të përfunduar, ndërsa 4% me arsim të lartë. Prej punëkërkesëve të pashkolluar, me arsim fillor dhe të mesëm shumica janë burra, përveç punëkërkesëve me Bachelor, Master apo PhD të cilat janë gra. Dallimet në mes të burrave dhe grave në nivel të arsimit lë të kuptohet që edhe te individët që kanë arsim të lartë do të ketë më shumë gra se sa burra të papunësuar. Kjo mund të vijë si pasojë e kriterëve të larta që hasin gratë gjatë kërimit të një pune qoftë të përshtatshme apo të papërshtatshme me fushën e saj të arsimit, gjë që mund të çojë në një mospërputhje mes atyre dhe një pjesëmarrje më të ultë të grave në treg të punës në përgjithësi.⁸

Figura 7. Niveli i arsimit i punëkërkesëve të rinjë gjatë periudhës janar-prill 2020



Burimi: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

8 "Analizë e shkurtër mbi mospërputhjen e arsimit dhe profesionit në Kosovë," Instituti GAP, Prill, 2020.
Burimi: <https://bit.ly/3dsLtqS>

Pakot emergjente fiskale për zbutjen e rreziqeve të papunësisë

Për t'i zvogëluar pasojat socio-ekonomike të pandemisë, Qeveria e Kosovës ka pranuar ndihmë financiare prej afro 52 milionë euro nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), rreth 70 milionë nga Bashkimi Evropian (BE)⁹ dhe mjete ndihmëse nga shtete dhe organizata të tjera¹⁰. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës ka miratuar nisma të negociimit të marrëveshjeve për kredi në mes të Ministrisë së Financave dhe Transfereve dhe një numri të institucioneve ndërkombëtare financiare. Gjithashtu, si masë lehtësuese, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) vendosi që t'u mundësohet pezullimi i pagesave të kësteve të kredisë qytetarëve dhe bizneseve nga data 16 mars deri me 30 prill 2020.¹¹

Ndërkaq, me vendimin Nr.01/19, më 30 mars 2020, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Pakon Emergjente Fiskale e cila përmban 15 masa (Figura 7) për intervenim të menjëhershëm financiar në situatën e krijuar si pasojë e pandemisë COVID-19.¹² Katër ditë më vonë, Ministria e Financave dhe Transfereve ka aprovuar edhe Planin Operacional për zbatimin e pakos emergjente fiskale.¹³ Pesha financiare e pakos emergjente fiskale arrin vlerën e mbi 179 milionë euro. Masa të ngjashme kanë marrë edhe shtetet në rajon si për shembull Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi me fonde për rimëkëmbjen e sistemit shëndetësor dhe bizneseve të vogla, rritjes së skemës sociale, mbështetjes së eksportuesve e të tjera.¹⁴

Komisioni Evropian poashtu ka lansuar një instrument të përkohshëm - Mbështetje për të lehtësuar Rreziqet e Papunësisë në raste Urgjente (SURE) – me vlerë prej 100 miliardë euro me qëllim që shtetet anëtare të BE-së të kenë mundësi të marrin kredi për lehtësim të papunësisë të shkaktuar nga pandemia COVID-19.¹⁵ Më saktësisht, kreditë do të lehtësojnë krijimin e skemave të punësimit afatshkurtër për të ndaluar rritjen e papunësisë. Nëse një shtet evropian e sheh të arsyeshme krijimin e një skeme punësimi për biznese apo të vetëpunësuar që kanë pësuar rënie të aktivitetit apo të të hyrave si pasojë e pandemisë, atëherë ai shtet mund të aplikojë për kredi përmes instrumentit SURE për mbulimin e shpenzimit të parasë publike si pasojë e krijimit të punësimit. Më pas, Komisioni Evropian së bashku me shtetin përkatës dhe në bazë të rritjes së shpenzimeve publike i definon kriteret e kredisë. Hapi i fundit është në dorën e Këshillit Evropian i cili vendos pranimin apo refuzimin e kredisë. Përveç të hyrave familjare që do të mbrohen nga ky program, stabiliteti i tregut të punës dhe produktiviteti i ekonomisë parashihet të ruhet.

9 Augustin Palokaj, "BE-ja ndihmon Kosovën me afër 70 milionë euro për t'u përballur me pasojat e koronavirusit," KOHA, 25 Mars, 2020. Burimi: <https://bit.ly/2zkdh1B>

10 "FMN aprovoi financimin për Kosovën në vlerë prej 52 milion," Ministria e Financave dhe Transfereve, 10 Prill, 2020. Burimi: <https://bit.ly/2zfcjUB>

11 "Komunikatë e përbashkët nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Shoqata e Bankave të Kosovës," Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, 15 Mars, 2020. Burimi: <https://bit.ly/2yyUyiP>

12 Vendimi i Qeverisë së Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3bCWLr4>

13 Ministria e Financave dhe Transfereve. Burimi: <https://bit.ly/2WA8uT3>

14 "Policy Responses to COVID-19," FMN. Burimi: <https://bit.ly/3dhgVes>

15 "A European instrument for temporary Support to mitigate Unemployment Risks in an Emergency (SURE)," Komisioni Evropian. Burimi: <https://bit.ly/3g6OdMu>

Tabela 5. Pakoja Emergjente Fiskale e Qeverisë së Kosovës me vlerë 179,650,000€

Masat	Përshkrimi	Vlera në Euro
Masa 1	Pagesa e dyfishtë e vlerës së skemës sociale (2 muaj)	7,650,000
Masa 2	Pagesa shtesë prej 30 euro në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale nën 100 euro (3 muaj)	13,000,000
Masa 3	Mbështetja financiare për shoqëritë tregtare (mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej 170 euro (2 muaj), subvencioni i qirasë deri në 50% të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, mbulim i vlerës së kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e parapara me këtë vendim)	61,000,000
Masa 4	Sigurimi i huadhënies pa interes për ndërmarrjet publike (kthimi deri në fund të vitit 2020)	20,000,000
Masa 5	Sigurimi i mbështetjes financiare për Komunitatet e Republikës së Kosovës.	10,000,000
Masa 6	Sigurimi i shtesës mbi pagën në vlerë 300 euro për punonjësit e sektorëve esencjal (2 muaj)	15,000,000
Masa 7	Pagesë shtesë prej 100 euro për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe barnatoreve (2 muaj)	3,000,000
Masa 8	Pagesa e asistencës mujore prej 130 euro për qytetarët që humbin vendin e tyre të punës (3 muaj)	4,000,000
Masa 9	Mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikë e Kosovës.	2,000,000
Masa 10	Sigurimi i likuiditetit financiar për mikro-ndërmarrjet e të vetëpunësuarit në shumë deri në 10 mijë euro për një periudhë 2 vjeçare.	15,000,000
Masa 11	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për rritje të prodhimit bujqësor.	5,000,000
Masa 12	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për evitimin e situatës së krijuar nga gjendja e emergjencës së shëndetit publik në aktivitetet sportive dhe kulturore.	5,000,000
Masa 13	Mbështetje për eksportuesit në Republikën e Kosovës pas përfundimit të situatës së emergjencës së shëndetit publik.	10,000,000
Masa 14	Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku një (1) vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik, nga 130 euro euro për dy muajt pasues pas regjistrimit.	6,000,000
Masa 15	Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej 130 euro euro për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, e që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga Buxheti i Kosovës (3 muaj)	3,000,000

Një pjesë e pakos emergjente në Kosovë është e dedikuar ose në subvencionimin e pagave të atyre që kanë humbur vendet e punës si pasojë e pandemisë ose si formë e asistencës sociale për personat e papunë dhe në kushte të rënda sociale. Ndonëse është herët për të matur efektin e secilës masë veç e veç, më poshtë do të analizojmë shkurtazi vetëm katër nga këto masa që ndërlidhen me punën dhe punësimin.

Masa 3, parasheh mbështetje financiare për shoqëritë tregtare përmes mbulimit të shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej 170 euro për dy muaj, si dhe mbulim të vlerës së kontributeve pensionale për ato paga. Vetëm për mbulimin e pagave, pakaja parasheh një shumë prej 41 milionë euro.¹⁶ Për të përfituar nga kjo masë, deri më 6 maj 2020, kanë aplikuar 37 mijë ndërmarrje dhe totali i punëtorëve të përfshirë në këtë masë është 133 mijë.¹⁷ Sikur të gjitha aplikacionet të kishin qenë të suksesshme, kostoja e përgjithshme e kompensimit për këtë masë do të arrinte në rreth 43 milionë euro, pak më shumë se shuma e paraparë për këtë masë.

Por një numër i aplikacioneve ishte refuzuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve ose për shkak të gabimeve në futjen e të dhënave në sistem ose për shkak të tendencave për keqpërdorime sikurse në rastin e shumë supermarketeve, barnatoreve dhe furrave që kanë aplikuar për rimbursim të pagave edhe përkunder se kanë qenë të hapura gjatë gjithë kohës ose sikurse me rastin e institucioneve edukative arsimore private të cilat kanë zhvilluar aktivitetet online.¹⁸ Deri më 30 prill 2020, gjithsej 41,177 punonjës kanë përfituar nga kjo masë, pas aprovimit nga komisioni i autorizuar për shqyrtimin e këtyre aplikacioneve.¹⁹

Por ekzekutimi i kësaj mase është paraparë të bëhet në dy forma të ndryshme. Në rast se punëdhënësi, përkundër vështirësive financiare, ka kryer pagat e muajit mars në tërësi, pagesa prej 170 euro për punëtorët kreditohet në llogarinë e punëdhënësit si rimbursim i shpenzimeve. Në rrethim, paga e muajit prill kreditohet në llogarinë e punëmarrësit.²⁰ Ky dualitet i kreditimit ka shkaktuar paqartësi në mesin e punëdhënësve dhe punëmarrësve, gjë që ka shtyrë këta të fundit të ankohen se bizneset kanë përfituar në emrin e tyre.²¹

Masa 8 parasheh një pagesë të asistencës mujore prej 130 euro për tre muaj për qytetarët që kanë humbur vendin e tyre të punës për shkak të situatës së pandemisë. Kjo masë parasheh një shumë prej katër milionë euro.²² Për të përfituar nga kjo masë, punëtorët duhet të kenë qenë në listën e pagave të muajit shkurt. Po ashtu, ish-punëtorët duhet të jenë larguar nga puna si rezultat i rënies së aktivitetit të ndërmarrjes ku kanë punuar. Ndonëse ende nuk dihet numri i saktë i personave të cilëve u është shkëputur kontrata e punës gjatë kohës së pandemisë, fakti se gjatë muajit prill kemi mbi 32 mijë të papunë të rinj të regjistruar pranë zyreve të punësimit nënkupton se një pjesë e tyre i takojnë kësaj kategorie. Megjithatë, për të përfituar nga kjo masë përfituesit nuk mund të jenë përfitues edhe të skemave të tjera.²³

16 Qeveria e Kosovës. Pakoja Emergjente Fiskale. Burimi: <https://bit.ly/35Zj9cW>

17 Ministria e Financave dhe Transfereve, <https://bit.ly/3gwkuwR>

18 Ministria e Financave dhe Transfereve, <https://bit.ly/3c9Mrro>

19 Ministria e Financave dhe Transfereve, <https://bit.ly/2zDWmlz>

20 Ministria e Financave dhe Transfereve, <https://bit.ly/2XbOzKt>, qasur më 24.05.2020

21 Kallxo.com. "I lene punetoret pa rrogat e qeverise, pronare aplikuan me llogari te bizneseve", <https://bit.ly/2M62ivV>

22 Qeveria e Kosovës. Pakoja Emergjente Fiskale. Burimi: <https://bit.ly/35Zj9cW>

23 Ministria e Financave, <https://bit.ly/2yFoZky>

Tabela 6. Punëtorët që aplikuan nga masa 14 sipas komunave


Komuna	Gra	Burra	Përfitues në total
Prishtinë	1,386	2,423	3,809
Ferizaj	404	1,253	1,657
Prizren	409	809	1,218
Gjilan	298	822	1,120
Pejë	282	502	784
Fushë Kosovë	193	468	661
Gjakovë	180	389	569
Suharekë	102	412	514
Lipjan	97	381	478
Malishevë	70	353	423
Podujevë	102	293	395
Vushtrri	98	284	382
Mitrovicë	89	264	353
Viti	73	194	267
Kaçanik	57	187	244
Glllogoc	75	159	234
Istog	51	164	215
Kamenicë	48	162	210
Klinë	51	159	210
Shtime	32	136	168
Skenderaj	42	122	164
Rahovec	42	116	158
Obiliq	22	127	149
Graçanicë	56	84	140
Dragash	12	112	124
Deçan	27	72	99
Hani i Elezit	9	49	58
Shtërpcë	5	28	33
Klllokot	3	27	30
Partesh	10	11	21
Mamushë	1	15	16
Junik	5	10	15
Novobërdë	4	4	8
Mitrovicë Veriore	2	1	3
Zveçan	1	2	3
Zubin Potok	2	0	2
Totali	4,340	10,594	14,934

Burimi: Ministria e Financave dhe Transfereve.

Masa 14 parasheh mbështetje financiare prej 130 euro për dy muajt për shoqëritë tregtare të cilat gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik regjistrojnë punëtorë me kontratë pune së paku një vjeçare. Kjo masë ka një vlerë financiare deri në gjashtë milionë euro.²⁴ Për të përfituar punëdhënësi nga kjo masë, kontrata duhet të jetë e nënshkruar pas fillimit të pandemisë në Kosovë dhe të jetë në kohëzgjatje jo më pak se një vit.²⁵ Sipas Ministrisë së Financave dhe Transfereve, afro 15 mijë punëtorë janë paraqitur për përfitime nga Masa 14. Më së shumti persona janë punësuar në këto komuna: Prishtinë (3,809), Ferizaj (1,657), Prizren (1,218), dhe Gjilan (1,120). Në shumicën e komunave, punëtorët ishin kryesisht burra.

Punëtorët që aplikuan për të përfituar nga Masa 14 ishin kryesisht të moshave të reja prej të cilave dominonin punëtorët me 25-39 vjeç (6,214), pastaj ata me 15-24 vjeç (5,054), në radhe ata me 40-54 vjeç (2,791), dhe përfundimisht ata mbi 55 vjet (875).

Figura 8. Aplikuesit nga masa 14 sipas moshës



Burimi: Ministria e Financave dhe Transfereve

Nga aplikuesit prej Masës 14, pjesa dërrmuese apo 23% e të gjithë punëtorëve vinin nga industria e tregtisë me shumicë dhe pakicë, të ndjekur nga 19% të punëtorëve nga industria përpunuese, 18% nga ndërtimtaria, dhe 17% nga akomodimi dhe shërbimi ushqimor. Edhe në bazë të industrive, në shumicën prej tyre dominojnë burrat, si për shembull në industri përpunuese me 75%, apo në ndërtimtari me 93%. Megjithatë, në disa prej industrive ka një balans, si për shembull në atë të tregtisë me shumicë dhe pakicë ku 41% apo gati gjysma janë gra. Faktikisht, ka edhe industri ku gratë dominojnë, si për shembull në arsim (82%) dhe shëndetësi e mirëqenie (71%).

Ndërsa sa i përket pozitive, ato ndryshojnë për nga gjinia. Tek burrat, pozitat dominuese janë kamarier, shofer, dhe punëtor në ndërtimtari, kurse tek gratë pozitat më të shpeshta janë kuzhinierë, pastrues dhe shitëse. Pra, sipas Ministrisë së Financave dhe Transfereve, numri i punëtorëve të rinj në sektorin

²⁴ Qeveria e Kosovës. Pakoja Emergjente Fiskale. Burimi: <https://bit.ly/35Zj9cVW>

²⁵ Ministria e Financave dhe Transfereve, Masa 14, <https://bit.ly/2M8QCZA>

privat të regjistruar gjatë periudhës prill-maj 2020 është 14,939.²⁶ Kjo masë mund të ketë ndikuar në formalizimin e sektorit të punësimit. Andaj, një analizë më e detajuar e kësaj mase mund të prodhonte një politikë afatgjate të stimulimit të ndërmarrjeve private për të regjistruar punonjësit e tyre.

Tabela 7. Aplikuesit për përfitim nga masa 14 sipas industrive

Industria	Gra	Burra	Përfitues në total
Tregtia me shumicë dhe pakicë	1,416	2,007	3,423
Industria përpunuese	702	2,062	2,764
Ndërtimtaria	197	2,461	2,658
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	653	1,825	2,478
Transporti dhe magazinimi	107	666	773
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	174	302	476
Shërbime tjera	244	208	452
Sherbime administrative	137	221	358
Informimi dhe komunikimi	110	201	311
Arsimi	228	49	277
Industria nxjerrëse	19	217	236
Shëndeti dhe mirëqenia	164	67	231
Bujqesia, pylltaria dhe peshkimi	80	101	181
Arti, argetimi dhe rekreacioni	28	80	108
Furnizimi me uje	6	40	46
Financa dhe sigurime	26	17	43
Administrimi publik dhe mbrojtja	14	19	33
Patundshmëria	13	16	29
Furnizimi me rryme, gaz, dhe avull	12	15	27
Mungon aktiviteti	8	16	24
Persona fizik	2	4	6
Totali	4,340	10,594	14,934

Burimi: Ministria e Financave dhe Transfereve

Masa 15 parasheh pagesën e asistencës mujore në vlerë prej 130 euro për tre muaj për qytetarët e regjistruar si të pa punë me kushte të rënda sociale dhe që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës. Vlera financiare e kësaj mase është tre milionë euro.²⁷ Shuma prej 130 euro në fakt është paraparë të jetë për familje e jo për individ, me kusht që përfaqësuesit e familjes të jenë të deklaruar si të papunë pranë zyreve të punësimit dhe ajo familje të mos jetë përfituese e skemave sociale dhe pensionale.²⁸ Nga numri i aplikimeve për të përfituar nga kjo masë, deri më tani janë aprovuar gjithsej 5,559 aplikacione.²⁹

²⁶ Të dhënat e siguruara nga Ministria e Financave dhe Transfereve pasqyrojnë numrin e aplikimeve deri më 20 Maj 2020,

²⁷ Qeveria e Kosovës. Pakoja Emergjente Fiskale. Burimi: <https://bit.ly/35Zj9cW>

²⁸ Ministria e Financave dhe Transfereve, Masa 15, <https://bit.ly/3cad4vK>

²⁹ Ministria e Financave dhe Transfereve, <https://bit.ly/3dcZdpJ>, qasur më 21.05.2020

Përfundim

Kriza emergjente shëndetësore e shkaktuar nga pandemia COVID-19 ka prekur direkt tregun e punës pothuajse në të gjitha vendet e botës. Kufizimi i lëvizjes ka shkaktuar rënie drastike të veprimtarive afariste në njërin anë, kurse mbyllja e plotë e shumë industrive ka lënë pa punë shumë punëtorë. Shkalla e jo aktivitetit ekonomik dhe shkalla e papunësisë në Kosovë kanë qenë në nivele të larta edhe para pandemisë, në veçanti papunësia e të rinjve, papunësia e grave dhe papunësia e të diplomuarve. Të dhënat nga Agjencia e Punësimit tregojnë se numri i punëkërkuësve gjatë muajit prill është rritur për 40 herë më shumë. Vetëm në katër muajt e parë të vitit 2020 Kosova ka të regjistruar mbi 37 mijë persona të papunë. Pa një plan gjithëpërfshirës të rimëkëmbjes ekonomike numri i të pa punëve mund të rritet edhe më shumë në muajt në vijim.

Por, lehtësimi i masave kufizuese dhe hapja graduale e veprimtarive biznesore nuk nënkupton edhe kthim të menjëhershëm në situatën e para pandemisë. E dyta, jo të gjitha veprimtaritë ekonomike pritet të hapën menjëherë. E dyta, jo të gjitha veprimtaritë që do të hapën do të kenë kërkesën e njëjtë për ofrim të mallrave apo shërbimeve. Dhe e treta, bota e pas-pandemisë mund të kërkojë veprimtari dhe shërbime të reja ekonomike të cilat kërkojnë edhe shkathtësi të reja. Andaj, bashkë me planin për rimëkëmbje ekonomike Kosova duhet të bëjë më shumë për të përafuar kërkesat e tregut të punës me arsimin dhe trajnimin profesional.

Në anën tjetër, situata e pandemisë do të mund të shfrytëzohej për të testuar disa politika të reja që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale. Me një kalkulim të saktë të kostos financiare, disa nga masat e ndërmarra nga institucionet e Kosovës do të mund të shndërroheshin në politika afatgjate qeveritare. Ndërmarrjet që regjistrojnë punëtorë të rinj me kontrata një vjecare do të mund të gëzonin mbështetje financiare nga ana e shtetit si përkrahje për kontributin e tyre në formalizimin e ekonomisë, sikurse në masën 14. Punonjësit që kanë qenë në marrëdhënie pune për një periudhë të caktuar do të mund të gëzonin të drejtën e një asistence mujore në rast të humbjes së vendit të punës, të ngjashme me masen 8.

Përfundimisht, tregu i punës mund të mos jetë më i njëjti sikurse në kohën e para pandemisë. Andaj, periudha e pas pandemisë mund të jetë një fillim i ri për shumë politika publike, përfshirë edhe ato të mirëqënies sociale.




Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Projekti “Inovacioni për mediat e qëndrueshme dhe angazhimin qytetar” implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

KOSOVO 2.0

Instituti GAP mbështetet nga:





European
Union
Kosovo